

VENDIM
Nr.697, datë 18.6.2009

PËR HAPJEN E FILIALIT TË UNIVERSITETIT PRIVAT “UFO UNIVERSITY”, NË QYTETIN E BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 1, 11, pika 2, shkronja “b”, 26, 33, 44 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në qytetin e Beratit, të filialit të Fakulteteve të Shkencave Shoqërore dhe të Shkencave të Aplikuara, si pjesë përbërëse e universitetit privat “UFO University”, Tiranë.

2. Hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) Shkenca politiko-administrative;
- b) Psikologji e përgjithshme;
- c) Shkenca të komunikimit;
- ç) Financë bankë.

3. Këto programe studimi të jenë të njëjta me programet e studimit, që universiteti privat “UFO University” ofron në selinë qendrore të tij, në Tiranë. Ato do të realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja e tyre do të jetë tri vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma e nivelit të parë (DNP), përkatësisht, në:

- a) Shkenca politiko-administrative;
- b) Psikologji e përgjithshme;
- c) Shkenca të komunikimit;
- ç) Financë bankë.

4. Hapjen e programeve të studimit, Master i nivelit të parë, në:

- a) E drejtë tregtare;
- b) E drejtë private;
- c) Shkenca penale.

5. Këto programe studimi të jenë të njëjta me programet e studimit, që universiteti privat “UFO University” ofron në selinë qendrore të tij, në Tiranë. Ato do të realizohen me, së paku, 60 kredite. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diplomë Master i nivelit të parë (MNP), përkatësisht, në:

- a) E drejtë tregtare;
- b) E drejtë private;
- c) Shkenca penale.

6. Ngarkohet universiteti privat “UFO University”, që, për çdo program studimi, sipas pikës 2 të këtij vendimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik, me kualifikimet e nevojshme.

7. Universiteti privat “UFO University” ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit të përcaktuara në pikat 2 e 4 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

8. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

9. Universiteti privat “UFO University” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha